

Profesional 2 vjeçar në **Menaxhim Sistemesh Informacioni**
(180 ECTC, 3 vite akademike, me kohë të plotë)

Profili profesional (PËRSHKRIMI I DEGËS)

Ky program studimi është projektuar për studentët të cilët kanë përfunduar me sukses ciklin e mesëm të studimeve. Gjatë zhvillimit të kurrikulës së këtij programi do ketë një vëmendje e veçantë ofrimi i aftësive praktike dhe zhvillimi i njohurive teorike në një nivel vështirësie të përshtatshëm për nivelin e studentëve të synuar për këtë program studimi.

Qëllimi i këtij programi studimi është edukimi i profesionistëve të lartë për ofrimin e shërbimeve në teknologjitë web, shërbime grafike dhe suport IT. Në përfundim të këtij programi studentët do jenë të aftë për të ndërtuar ndërfaqe dhe aplikacione të avancuara në web, të përpunojnë kryesisht imazhe dhe të ndërtojnë paraqitje grafike sipas kërkesave të klientëve etj.

Ky program studimi synon të ofrojë elementet dhe mjetet e nevojshme për zhvillimin e aftësive në fushën e sistemeve kompjuterike dhe sistemeve të Informacionit:

- Njohje e thelluar e sistemit kompjuterik
- Administrim të dhënash
- Data entry & Suport IT
- Projektim, zhvillim dhe mirembajtje e aplikacioneve të web
- Përpunimi i imazheve dhe ndërtimi i ndërfaqeve grafike

Modulet kryesore të trajtuara përgjatë studimeve të këtij programi:

a. Formim i përgjithshëm

1. Matematikë
2. Statistikë
3. Hyrje në Ekonomi Bujqësore

b. Formim baze karakterizues

1. Hyrje në Informatikë
2. Bazat Harduerë
3. Sisteme Shfrytëzimi
4. Algoritmikë & Str. të dhënash
5. Informatikë e Aplikuar
6. Bazat e të Dhënave
7. Programim në Python
8. Programim Web
9. Hyrje në Inxhinieri Softuer
10. Sisteme Informacioni
11. Logjikë Dixhitale

12. WordPress
13. Data Visualization

c. Formim integrues

1. Marketing
2. Adobe Illustrator & In Design
3. Sip&Biznesi i Vogël
4. Komunikim Biznesi
5. PHP & MySQL
6. E-bussines në Bujqësi

Mundësitë për punësim

Përfshirja dhe përvoja praktike gjatë edukimit po tregohet gjithnjë më e suksesshme se arsimit i përgjithshëm në promovimin e karrierës së të rinjve. Në fakt, meqë shumica e këtyre studentëve kombinojnë punën dhe edukimin, ata do të vihen në kontakt me punëdhënës relativisht më shpejt. Vetëpunësimi gjithashtu është një nga mundësitë që specialistët në fushën e shkencave kompjuterike në përgjithësi dhe programimit në veçanti po e shfrytëzojnë më së shumti kohët e fundit. Kjo mënyrë punësimi nënkupton se vetë specialisti ofrohet për të qënë zhvillues apo mirëmbajtës i platformave apo faqeve web drejtpërdrejt me kompaninë që e kërkon këtë shërbim. Janë të shumta platformat online që e ofrojnë mundësinë e kontaktit me projekte dhe kompani të ndryshme jashtë. Ky lloj punësimi njihet si “freelancer” dhe një numër i madh profesionistësh e shfrytëzojnë si punë primare ose si një mundësi për të punuar me kohë të pjesshme.

Nga vërtetimet e shumta që kemi bërë në tregun shqiptar, rezulton se ka kërkesë gjithnjë në rritje në fushat:

- data enty;
- administrim dhe përpunim të dhenash;
- suport IT;
- dizenjimit web;
- programimit web;
- dizenjimit grafik;
- përpunimit të imazhit
- mirëmbajtje faqe web etj.

PROGRAMI MËSIMOR

Viti, Sem	Nr	Modulet	Kredite
Viti I, Semestri I (1)	1	Matematikë	5
	2	Hyrje në Informatikë	5
	3	Bazat Hardware	5

	4	Adobe Illustrator & In Design	5
	5	Sisteme Shfrytëzimi	5
	6	Gjuhë e Huaj Teknike	5
Viti I, Semestri II (2)	1	Algoritmikë & Str. të dhënash	5
	2	Informatikë e Aplikuar	5
	3	Bazat e të Dhënave	5
	4	Programim në Python	5
	5	Hyrje në Ekonomi Bujqësore	5
	6	Marketing	5
Viti II, Semestri I (3)	1	Statistikë	5
	2	Programim Web	5
	3	Data Visualization	5
	4	Sisteme Informacioni	5
	5	Hyrje në Inxhinieri Software	5
	6	Logjikë Dixhitale	5
Viti II, Semestri II (4)	1	WordPress	5
	Modul me Zgjedhje 1		
	2	<i>Sipërmarja dhe Biznesi i Vogël</i>	4
		<i>Komunikim Biznesi</i>	
	Modul me Zgjedhje 2		
	3	<i>PHP & MySQL</i>	4
		<i>E-bussines në Bujqësi</i>	
4	Praktikë profesionale	12	
5	Teza Bachelor	5	
Totali i Krediteve		1+2+3+4	120